



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 21
Prishtinë, 14 tetor 2008, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V E R B A L

i mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Flora Brovina, Nurishahe Hulaj, Gjylnaze Syla, Mimoza Ahmetaj, Qamile Morina, Armend Zemaj, Bujar Bukoshi dhe Teuta Hadri.

Mungoi: Sllobodan Petroviq

Të pranishëm:

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj - administratore dhe Fatime Qorri - zyrtare ligjore.

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati

Mbledhjen e kryesoi z. Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe për punësimin e personave me aftësi të kufizuara,**
- 4. Shqyrtimi i Ligjit 02/L-73 për ndërprerjen e shtatzënisë,**
- 5. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen lidhur me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Nurishahe Hulaj – Tha se në procesverbalin e 23 shtatorit në diskutimin e saj “... në bazë të të dhënave, në Kosovë rreth 45 % e nënave nuk e dinë kur e kanë pasur menstruacionin e parë...”, ajo e kishte fjalën për ditën e parë të menstruacionit të fundit.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar me sqarimin e deputetes Nurishahe Hulaj.

Miratimi i procesverbalit të dëgjimi publik në Gjilan

Kryesuesi konstatoi se procesverbali i dëgjimit publik për gjendjen në shëndetësi në rajonin e Gjilanit u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe për punësimin e personave me aftësi të kufizuara

Sadik Idriz – Tha se grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe për punësimin e personave me aftësi të kufizuara i ka rekomanduar Komisionit ta kërkojë nga Ministria për Ekonomi dhe Financa një mendim për implikimet buxhetore të këtij projektligji dhe të amendamenteve të propozuara nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale, sidomos të neneve 12 dhe 27 të Projektligjit. Fjalën ia dha raportueses së grupit të punës, deputetes Flora Brovina.

Flora Brovina – Tha se grupi i punës është takuar dhe e ka shqyrtuar Projektligjin për rehabilitimin profesional dhe për punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe është pajtuar me rekomandimet e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale, por ky projektligj dhe rekomandimet e propozuara nuk kanë deklarata financiare, prandaj grupi i punës ka dalë me këtë rekomandim që të kërkohej mendimi nga Ministria për Ekonomi dhe Financa lidhur me implikimet buxhetore. Grupi i punës mund të takohet sërish dhe ta bëjë amendamentimin e këtyre rekomandimeve, por pa një deklarata financiare ky projektligj do të kthehet prapa nga Komisioni për Buxhet dhe Financa. Kuvendi ka marrë qëndrim që asnjë ligj të mos shkojë pa deklarata financiare.

Sadik Idriz – Tha se në rekomandimin që e ka dhënë Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale shihet që kjo ministri ka biseduar me Ministrinë për Ekonomi dhe Financa dhe me Shërbimin Doganor në lidhje me këto dispozita dhe se janë pajtuar që ky rekomandim të shkojë ashtu siç është proceduar në këtë komision. Propozoi që këto rekomandime të amendamentohen nga grupi i punës dhe të procedohet ky projektligj në Komisionin për Buxhet dhe Financa. Nëse Komisioni për Buxhet dhe Financa përsëri ka vërejtje, sa u përket implikimeve buxhetore, atëherë Komisioni do t'i drejtohet Kryesisë së Kuvendit të kërkojë informata shtesë nga Qeveria.

Teuta Hadri – anëtare e grupit të punës – Tha se Komisioni duhet të propozojë amendamente dhe ta procedojë ligjin.

Gjynaze Sylja – Tha se me Rregulloren e punës është definuar se asnjë ligj nuk mund të kalojë nëse nuk ka deklarata financiare. Andaj Ministria e Financave duhet të bëjë deklarata financiare se a ka Qeveria buxhet për zbatimin e këtij ligji.

Qamile Morina – Tha se sipas Rregullores së punës Projektligji duhet të ketë deklarata financiare. Askush nuk mund të arsyetohet për joseriozitet, duke pasur parasysh që ky ligj ka dy vjet që po sillet në Kuvend. Kjo kategori e njerëzve është shumë e rrezikuar dhe ka shumë nevojë për një ligj të tillë. Kërkoi nga Komisioni të insistojë që këto dy ministri ta marrin më seriozisht këtë ligj dhe sa më

shpejt ta dërgojnë raportin financiar, sepse Komisioni ka punuar me përkushtim të madh me se dhjetë muaj, por në fund rezultati doli zero.

Rita Hajzeraj – Tha se Komisioni nuk e ka neglizhuar për asnjë moment këtë ligj. Ministria e Financave ka deklaruar se për nga buxheti ky ligj është i pazbatueshëm. Propozoi të organizohet një debat me përfaqësuesit e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale dhe të Ministrisë për Ekonomi dhe Financa.

Bujar Bukoshi – Tha nëse sponsor është Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale, atëherë mos po krijohet një kolizion që Komisioni po ngatërrohet me Ministrinë e Financave që deri më tani si duket nuk ka prirje të komunikojë me këtë komision. Ishte i mendimit që sponsoruesi duhej ta çante kokën për këtë ligj dhe në rast se situata bllokohet atëherë Komisioni mund ta ngritë zërin dhe të bëjë presion.

Pas diskutimeve të deputetëve Komisioni e miratoi rekomandimin e grupit të punës që Komisioni të kërkojë nga Ministria për Ekonomi dhe Financa një mendim rreth implikimeve buxhetore të këtij projektligji dhe të amendamenteve të propozuara nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale, sidomos të neneve 12 dhe 27 të Projektligjit.

3. Shqyrtimi i Ligjit 02/L-73 për ndërprerjen e shtatzënisë

Sadik Idriz – Tha se grupi i punës për shqyrtimin e Ligjit 02/L-73 për ndërprerjen e shtatzënisë është takuar dhe i ka përgatitur propozimamendamentet. Fjalën ia dha raportueses së këtij grupi, deputetes Teuta Hadri.

Teuta Hadri – raportuese e grupit të punës – Tha se Komisioni është i njoftuar për arsyet pse ky ligj nuk është nënshkruar nga PSSP-ja. Grupi i punës është takuar dhe i ka përgatitur propozimamendamentet. Ajo i paraqiti amendamentet e përgatitura nga grupi i punës.

Gjynaze Syla – Tha se esenca e amendamentimit të këtij ligji është pikërisht caktimi i javës elektike për ndërprerjen e shtatzënisë. Grupi i punës ka propozuar që ky afat të jetë “10 javë” me arsyetimin se afati 12-javësh është në kundërshtim me ligjin bazik. E ftoi Komisionin të mendojë për interesin e femrës në Kosovë. Duke e marrë parasysh nivelin e vetëdijes së femrës në Kosovë, afati “12 javë” është shumë i arsyeshëm dhe është në harmoni me shumë vende të tjera që e lejojnë abortin deri në muajin e tretë, si: Austria, Belgjika, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Franca, Gjermania, Hungaria, Italia, Letonia, Holanda, Sllovakia dhe Suedia.

Nëse afati elektik për ndërprerjen e shtatzënisë mbetet vetëm “10 javë”, gratë do të bëjnë aborte ilegale dhe joprofesionale.

Teuta Hadri – Tha se aborti në 12 javë nuk ka mundësi të bëhet në Kosovë. Formohet koka, diametri i së cilës është 3.7, femuri është 1.7 dhe është kockë, ndërsa në 10 javë është kërc. Propozimi që afati për ndërprerjen e shtatzënisë të mbetet “10 javë” e jo “12 javë” është profesional. Duhet të mendohet për gjendjen psikike të pacientit, por edhe për mjekun që do ta bëjë ndërprerjen e shtatzënisë.

Gjynaze Syla – Tha se ka punuar për shëndetin riprodhues dhe sipas të dhënave, që ka mbledhur ajo, mjeti kryesor kontraktiv në Kosovë është aborti. Nuk hoqi dorë nga qëndrimi i saj që ky afat të mbetet “12 javë” për të mirën e femrave në Kosovë. Nëse ndodh që ky afat të mbetet “10 javë” aborti do të bëhet në rrugë joinstitucionale.

Mimoza Ahmetaj – Tha se në spitalet e Kosovës abortet bëhen pa anestezi. Llogariteni çfarë traume është për pacientin, duke marrë parasysh ndryshimet që bëhen në javën e 10-të dhe të 12-të. Askush nuk mund të llogaritë, se nëse përkrahet propozimin që ky afat të jetë 12 javë do të ndërrohet shkalla e vetëdijesimit në Kosovë për këtë çështje. Propozoi të mbështetet propozimi që ky afat të jetë 10 javë mbasi këtë e kanë vlerësuar ekspertët. Ligji nuk e ndalon që aborti të bëhet edhe mbas javës së 10 - të, nga komisioni profesional.

Sadik Idriz – Tha se ky ligj është kthyer për këtë arsye. Në mandatin e kaluar ai ka propozuar që afati të jetë 10 javë, sepse edhe me Ligjin për shëndetësinë është paraparë që ky afat të jetë 10 javë.

Kryesuesi i ftoi anëtarët e Komisionit ta votojnë propozimamendamentin e grupit të punës:

Në nenin e 6-të në vend të „javës së 12-të”, të bëhet „javës së 10-të”.

Kryesuesi konstatoi se me: pesë vota për, një kundër dhe tri abstenime, miratohet propozimamendamenti i grupit të punës.

Gjylnaze Syla – Tha, nëse neni 6 është në kundërshtim me Ligjin për shëndetësinë, atëherë edhe heqja e termit “frytnim” është në kundërshtim me ligjin bazik, sepse ky ligj e ka termin “frytnim” e jo “fekondim”. Pra Komisioni duhet të vendosë nëse dëshiron ta bëjë harmonizimin e këtij ligji me Ligjin për shëndetësi.

Pse kanë hyrë këtu termat “gametë” dhe “zigot”?

Përkufizimi i termit “abort”- nëse aborti është ndërprerje e shtatzënisë me dhunë, me dëshirën e çiftit, atëherë kjo nënkupton që gruaja nuk mund të vendosë vetë për ndërprerjen e shtatzënisë sipas vullnetit të saj. Kjo po ashtu është në kundërshtim me nenin 4, sipas të cilit gruaja vendos vetë. Propozoi që ky saktësim të mbetet “abort - ndërprerje e shtatzënisë me dhunë, me dëshirën e gruas”. Neni 3 nuk është koherent me nenet e tjera.

Te neni 4 duhet të shtohet edhe një nen, sipas të cilit gruaja duhet të ketë të drejtë për informata dhe edukatë seksuale.

Me nenin 12 nuk garantohet trajtimi mjekësorë adekuat brenda institucionit. Duhet një nen i posaçëm, me të cilin i sigurohet gruas trajtimi institucional shëndetësor.

Neni 18 thotë: burra dhe femra, duhet të jetë burra dhe gra, ose duhet të jetë meshkuj dhe femra. Neni 21.2 nuk duhet të hiqet sepse nuk parasheh që gjykata të vendosë për këtë çështje.

Teuta Hadri – Tha se “fekondimi” është faza kur spermatozoidi e shpërthen membranën dhe futet në protoplazmë të qelizës dhe takohet me qelizën vezë. Ai e ka fekonduar, por nuk është takuar. Ndërsa “frytnimi” është fryt me zemër dhe procese të tjera.

“Gametë” dhe “zigot” janë terma të Ligjit të abortit.

Duhet të futet fjala “embrion”, sepse para se të krijohet fryti, formohet embrioni.

Përkufizimi për abortin është bërë si vijon: “Abort- ndërprerje e shtatzënisë me dhunë, me dëshirën e çiftit”, sepse mund të ndodhë që aborti të bëhet kudër dëshirës së prindit.

Neni 21.2 është propozuar të hiqet, sepse nuk ka mundësi për ta bindur njeriun që ta heqë fëmijën 20- javësh. Cili gjinekolog do ta bënte këtë pa pagesë?

Rita Hajzeraj – Tha se e ka përkrahur propozimin që të futet termi “fekondim”, sepse ky ndodh para “frytnimit”. Kjo çështje nuk është në Ligjin për shëndetësi, por ai ligj është më i përgjithësuar.

Mimoza Ahmetaj – Propozoi që te përkufizimi për abortin pas fjalës “me dhunë” të hiqen fjalët “me dëshirën e çiftit”.

Kryesuesi i ftoi anëtarët e Komisionit të votojnë për propozimamendamentet e paraqitura në mbledhjen e Komisionit lidhur me shqyrtimin e Ligjit 02/L-73 për ndërprerjen e shtatzënisë:

Amendamenti 1

Në bazë të nenit 65, pika (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Amendamenti 2

Neni 1 riformulohet si vijon:

Ky ligj e vendos bazën ligjore për rregullimin e ndërprerjes së shtatzënisë.

Qëllimi i vendimit për lejimin e ligjit për ndërprerjen e shtatzënisë bëhet për shkaqe informative, shëndetësore dhe të largimit të rrezikshmërisë së jetës.

Qëllim tjetër është të merren të gjitha masat për ta mbrojtur femrën nga rreziku i rritjes së sëmundshmërisë dhe të vdekshmërisë si pasojë e aborteve ilegale.

Sigurimi i jetës së femrës në rrugë institucionale duke e larguar nga format me të vrazhda dhe jomjekësore, jashtinstitucionale, që e shkaktojnë edhe vdekjen.

Amendamenti 3

Para termit fekondim hyjnë termat:

„**gametë** - qeliza seksuale që e përcaktojnë seksin (qeliza veze dhe spermatozoidi).”

„**zigot** - bashkim i qelizës mashkullore dhe i qelizës së vezës”.

Hiqet „**frytnimi**” dhe zëvendësohet me „**fekondimi**”.

Pas fekondimit hyjnë termat:

„**embrioni** - organizëm i gjallë nga çasti i fekondimit deri në muajin e tretë të shtatzënisë.

“**abort** - ndërprerje e shtatzënisë me dhunë”.

Te termi „**fetusi**”, në vend të „**12**” bëhet „**10**”.

Amendamenti 4

Në nenin 6, në vend të „**javës së 12-të**”, bëhet „**javës së 10-të**”.

Amendamenti 5

Pas nenit 6 shtohet një nen i ri, si vijon: “Çdo ndërprerje e shtatzënisë pas javës së 10-të është në kundërshtim me Ligjin e shëndetësisë dhe duhet të bëhet me komision shëndetësor profesional”.

Amendamenti 6

Te neni 21 hiqet paragrafi 21.2 .

Amendamenti 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Kryesuesi konstatoi se u miratuan amendamentet e propozuara më lart.

5. Të ndryshme

Sadik Idriz – I njoftoi anëtarët e Komisionit për kërkesën e Komisionit të Shëndetësisë dhe të Mirëqenies Sociale të komunës së Prishtinës, për t’u takuar urgjentisht me Komisionin Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale që të hartojmë politika të përbashkëta, në mënyrë që të dalim nga gjendja e rëndë e shëndetësisë. Po ashtu i njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me vendimin e Ministrisë së Shëndetësisë për kërkesat e FSSHK-së.

Propozoi që Komisioni të dalë me një qëndrim për grevën e punëtorëve shëndetësorë.

Pas diskutimeve të deputetëve Komisioni lidhur me grevën e punëtorëve shëndetësorë doli me këtë

P e r f u n d i m

- *Komisioni në vazhdimësi i përcjell gjendjen dhe problemet, me të cilat ballafaqohet shëndetësia në Kosovë.*
- *Komisioni i përkrah kërkesat legjitime të punëtorëve shëndetësorë .*
- *Komisioni e çmon angazhimin e Qeverisë së Kosovës dhe të Ministrisë së Shëndetësisë për një zgjidhje përkatëse dhe e inkurajon Ministrinë e Shëndetësisë të vazhdojë në këtë drejtim .*
- *Komisioni është i gatshëm të punojë me angazhim të shtuar për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve nga Kuvendi i Kosovës, që janë pjesë e kërkesave të punëtorëve shëndetësorë.*

Qamile Morina – E njoftoi Komisionin lidhur me monitorimin e Ligjit për ushtrimin e veprimtarisë private në shëndetësi. Tha se anëtarët e grupit për monitorimin e Ligjit, që vullnetarisht janë deklaruar për pjesëmarrje në këtë grup, shumë prej tyre nuk marrin pjesë në vizitat që organizohen me qëllim monitorimi të këtij ligji. Ka ndodhur që vetëm dy nga anëtarët e grupit të jenë pjesëmarrës. Grupi do ta vazhdojë monitorimin në Prizren. Kërkoj nga anëtarët e grupit të jenë seriozë, në mënyrë që javën e ardhshme ky grup t’i përfundojë vizitat dhe ta përgatitë raportin përfundimtar.

Flora Brovina – Tha se në momentin kur në grupin e punës për monitorimin e Ligjit mungojnë disa anëtarë, atëherë lejoni vetes, si kryesuese e grupit, të ftoni edhe anëtarë të tjerë të Komisionit të marrin pjesë.

Nurishahe Hulaj – I njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me draftin e vlerësimit të zbatimit të Ligjit për duhanin që ajo e ka përgatitur si anëtare e Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për duhanin.

Mbledhja përfundoi në orën 12:26

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit
Sadik Idriz